

FJALA E DEPUTETIT FATION VEIZAJ

E ENJTE 30 QERSHOR 2022

Të nderuar kolegë,

Ky parlament po kthehet në një mekanizëm spekulimi. E them këtë, për shkak të hipokrizisë me të cilën ndan dhe mbështet përparësitë politike të pozitës, pra interesat imediate të pushtetit. Në parim, akti normativ nr. 10, datë 18.05.2022, nuk është për t'u qortuar, është i arsyeshëm në pamje të parë. Kompensimi i kompanive që kryejnë punë publike në kushtet e reja të rritjes së çmimeve do të dëshmonte përgjegjshmëri në rrethana të tjera. Kam parasysht domosdoshmërinë e ruajtjes së ritmit të punimeve, shmangien e proceseve të falimentimit, pasojat që sjell kjo, mbrojtjen e investimeve publike e të tjera si këto. Por kjo nuk është rrethana jonë ose me saktë kjo është vetëm një pjesë e saj, mbi të cilën po spekulohet, për më tepër kur të gjithë e njohim segmentin e të privilegjuarve që i kanë marrë të gjitha kontratat publike, ndonëse sot nuk dua të merrem me këtë pjesë.

Suficiti i shtetit shqiptar sot është 170,5%, shteti po fiton, ndërsa shtetasit e tij po varfërohen. Meqë këto kohë pëlqehet frazeologjia e luftës, do t'i referohem një kolegut tonë të nderuar, ish-anëtar i këtij parlamenti, i cili ka shkruar: "Kush pasurohet në luftë, është spekulant", apo jo? Te ne, spekulanti më i madh është shteti. Ky 170,5 % fitim i shtetit përbëhet nga paratë u merren të gjithëve, popullit, të cilët nuk kanë më para për të blerë naftë, miell, oriz, vaj, makarona, vezë e mish, sepse nuk i kanë çmimet si më parë. Është i njëjti shtet, i cili, duke përdorur luftën, krijon përparësi legislative e administrative në thelb për veten, si kjo e sotmja. Përse nuk i shkon mendja qeverisë të indeksojë pagat dhe pensionet me nivelin real të inflacionit, por miraton akt normativ për kontratat e punëve publike.

Përse i ka ulur pagesat për asistencë sociale? Natyrisht, nuk është normale t'i kërkohet spekulantit empati sociale, e kuptoj. Qeveria edhe sot, pas 9 vjetësh pas ardhjes në pushtet, nuk e ka aktivizuar nenin 95 të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", VKM-në për miratimin e kriterëve dhe procedurave për miratimin e statusit të klientit në nevojë. Edhe VKM-ja e

famshme nr. 8 e vitit 2015, që përmendet në studiot televizive, si mbrojtje e klientëve në nevojë, faktikisht lidhet me kompensimin e 648 lekëve në muaj të çmimit të energjisë elektrike, për shkak të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 kilovat/orë. Pra, është një vendim i marrë për të kompensuar dëmin që vetë ju u shkaktuar atyre, duke rritur çmimin e energjisë nga 7,7 në 9,5 lekë dhe jo për të mbrojtur shtresat në nevojë, siç e ka përcaktuar ligji.

Ky është thelbi i hidhur i rrethanës sonë. Megjithatë, përfitoj nga rasti dhe dua, gjithashtu, t'i bëj të njohur opinionit një lëvizje tjetër të pushtetit, hartën e re gjyqësore, që po i shqetëson qytetarët mbarë dhe komunitetin e avokatisë. Harta e re gjyqësore vlen të analizohet me kujdes, jo vetëm për domosdoshmërinë e informimit publik mbi të, përkatësisht pasojave që do të ketë herët a vonë në jetën e çdo qytetari të Republikës së Shqipërisë, por edhe për nevojën për të kuptuar se çfarë prodhon ky projekt, si mendësi në rrafshin politik, legjislativ, administrativ, moral dhe social. Le t'i shohim me radhë. Së pari, të bën përshtypje interpretimi në mënyrë mekanike, që përshkon projektin. Kriteri i çështjeve për numër gjyqtarësh e cilëson apriori një regjistër uniform natyrën e çështjeve për gjykim, e cilëson aktin e gjykimit si një proces krejtësisht të parashikueshëm dhe pa dhënë asnjë argument për strukturën optimale të procesit, pra për cilësinë e gjykimit dhe tërësinë e rrethanave, që krijojnë parakushtet për cilësinë.

Pra, nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me shembujt e mirë apo dështimet e vërtetuara. Vendoset arbitrarisht një raport numerik, që fshin realitetin konkret të dhënies së drejtësisë në të gjithë përbërësit e vet. Çështjet për gjykim nuk janë një fakt numerik pa përmbajtje. Natyrën e tyre, vlerën e seancave të zhvilluara, arsyetimin funksional të vendimeve, kohën e nevojshme të procedurës ligjore, i fshin të gjitha ky projekt, duke e ngurtësuar aktin e gjykimit. Projekti është kontradiktor në vetvete, niset në premisën e kriterit gjyqtar-çështje, por e realizon po vetë propozimin e tij. Është e çuditshme pseja e mbylljes së Gjykatës së Apelit në Vlorë, e cila shqyrton më shumë çështje se të gjitha gjykatat e tjera të Apelit. Shtojmë se, nëse mbyllja e gjykatave të Apelit do të mbështetej mbi këtë kriter, pavarësisht rastit të Vlorës, që është një shkelje e qartë e kriterit të propozuar nga vetë KLGJ-ja, sërish do të krijohet një gjendje absurde.

Gjykata e Apelit Tiranë sot, nëse do të krijohet me të gjithë 25 gjyqtarët e mbetur në sistem, është e detyruar të trajtojë afërsisht 11 400 çështje në vit, sipas rendimentit të përcaktuar, por në Gjykatën e Apelit Tiranë vetëm ngarkesa për vitin 2021 ka qenë 20 350 çështje, po t'i shtosh edhe ngarkesën e mbartur, numri i tyre shkon rreth 40 mijë. Në rast se projekti do të zbatohet, me të dhënat e deritanishme për numrin e gjyqtarëve të Apelit, çështjet e vitit 2021 do të merrnin kohë të paktën deri në vitin 2024. Barra e kohës, që krijon ky projekt, është e papërballueshme. Është e paqartë si parashikohet projekti për këtë eventualitet. Ajo që më bën përshtypje është pjesa e plotë e vëmendjes për objektet e gjykimit, qytetarët. Harta gjyqësore, në tërësinë e saj, mban parasysh reduktimin e kostove të shtetit, por në asnjë element nuk llogarit kostot e një procesi gjyqësor për individin, që është element mjaft i rëndësishëm për garantimin e aksesit në gjykatë.

Është analizuar largësia në kilometra nga pika më e largët e Shqipërisë deri në Tiranë për Gjykatën e Apelit dhe nuk është llogaritur kostoja e transportit, kostoja e humbjes së ditës së punës, kostoja e përfaqësimit, kostoja e shtyrjes së seancave të tjera në gjykatat e shkallës së parë për mungesë të avokatit, kosto të gjitha këto që shkarkohen mbi individin. Duhet të ishte llogaritur që kostoja e një gjykimi nuk është largësia në kilometra, pasi distanca vajtjeardhje që do të përshkohet nuk është elementi kryesor. Pala e përfaqësuar, përveç kostove të transportit, humbet edhe ditën e punës, kurse avokati do të shtyjë seanca të tjera gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë, duke sjellë për pasojë zvarritjen e tyre. Një shembull të qartë për këtë punë: në qoftë se IKMT-ja, që i ka gjobat e përcaktuara, minimalisht 500 mijë lekë të rinj për një lopatë beton në Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, në një gjobë, kundërshtimi i kësaj gjobe mund të bëhet vetëm në Gjykatën Administrative në Lushnjë.

Shpenzimi për këtë proces është më i madh se vetë gjoba. Rruga, largësia e bën qytetarin të mos zgjedhë rrugën gjyqësore, çka i përbën atij mohimin e aksesit në drejtësi, duke shkelur një të drejtë themelore të qytetarit shqiptar. Pra, i bie më mirë të paguajë, të dorëzohet pa kushte. Ngado që ta kthesh, kjo hartë gjyqësore është shembull i një dështimi të pashmangshëm, nëse nxitësit dhe mbështetësit e projektit do ta shpien këtë aventurë deri në fund. Nuk e di se kujt i shërben. Ju faleminderit!